



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më 19.5.2023, me fillim në ora 10:10. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, zt. Defrim Kafexhiu.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'ju përshëndes të gjithëve, Nënkryetarin **Fatmir Iska**, drejtorët e drejtorive. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, përfaqësues të KFOR-it, zyrtarë komunalë, të gjithë ju të pranishëm. Faleminderit për pjesëmarrjen. E hapim mbledhjen e pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2023.

Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës P- 71510069-01910-6, në zonën kadastrale – Retijë;
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P- 71510069-01910-6, në zonën kadastrale – Retijë;
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës P- 71510002-01002-0, në zonën kadastrale – Bellacërkë;
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P- 71510002-01002-0, në zonën kadastrale – Bellacërkë;
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-7151057-02240-1, në zonën kadastrale – Rahovec;
7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për shpronësimin e pronës së paluajtshme P- 71510052-00363-0, Zona Kadastrale Mrasor;
8. Të ndryshme.

Shtesë: Informatë mbi qarkoren e parë buxhetore 2024/01.

Kryesuesi – Fillimisht po e vendosim në votim pikën shtesë! Kush është “për”?... Me shumicë votash edhe kjo pikë përfshihet në rendin e ditës për sot.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues! Përshëndetje nënkryetar, drejtorë, kolegë. Kërkoj që në seancën e rregullt të asamblesë komunale ta kemi një informatë rreth obligimeve financiare të komunës së Rahovecit (borxhet dhe obligimet kontraktuale) dhe një informatë financiare rreth shumës së mjeteve që përmes procedurës gjyqësore ose përmbarimore kanë përfituar komanitë apo individët, sepse kemi informata që ka të tilla gjëra, sidomos te kontratat kolektive, ose te faturat e papaguara.

Kryesuesi – Për me qenë më të qartë, a po propozoni pikë shtesë si informatë për përfshirje në rend dite, apo është vetëm pyetje për drejtorin?!

Burim Krasniqi – Në seancën e rregullt të jetë si pikë e rendit të ditës, drejtori të na informon! Praktikën e kanë thënë keq deri sot, nëse unë kam pyetje më vie informata vetëm mua! Unë pyetjen po e bëj për të gjithë asambleistët.

Nënkryetari – Përshëndetje kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, përfaqësues të KFOR-it, OSBE-së, të gjithë të pranishëm. Besoj që drejtori mund ta përgatis si informatë kërkesën e kuvendarit Burim Krasniqi, por, nuk besoj që mund ta përfundojë për seancën vijuese sepse materiali për kuvend shpërndahet sot pas përfundimit të KPF-së. I kemi edhe auditorët për moment në komunë dhe derisa ta përfundojnë punën ata, drejtori i financave është bukur i zënë.

Burim Krasniqi – Ndoshta ngarkesa mund ta bëjë të veten, por kërkoj nga drejtori që ta provojë ta kemi si pikë të rregullt, sepse praktikën tona thonë që në çdo seancë i kemi 2-3 pika që vijnë aty për aty. Në çoftëse vetëm një ditë para seancës ta kemi në email, për mua është e pranueshme.

Kryesuesi – Atëherë, sot po vazhdojmë me rendin e ditës ashtu siç është i përpiluar! Besoj që drejtori këtë kërkesë do ta marrë parasysh dhe në çoftëse arrin ta përgatisë informatën ditëve në vijim, do t'ia japim hapësirën për mbledhjen e rregullt të kuvendit.

Bejtullah Deliu – Faleminderit kryesues! I nderuar zv.kryetar, drejtorë, kolegë, pjesëtarë të KFOR-it. Në seancën e kaluar e kam dhënë një kritikë, duke thënë që gjatë seancës na vijnë pika të tjera të rendit të ditës dhe nuk kemi kohë të bëhemi gati për shqyrtim. Nëse një ditë apo dy, këtë informatë e kemi në email, pajtohem që mund të jemi gati, por nëse vie gjatë seancës, propozoj që të shtyhet.

Kryesuesi – Faleminderit Bejtullah! Në seancën e kaluar kemi diskutuar që ka shumë arsye që detyrohemi të shtojmë pika tjera shtesë në seancën e rregullt. Në rastin e seancës së kaluar që i kemi shtuar tre pika, është dashur me patjetër të shfuqizohen, sepse obligohemi me ligj t'i përgjigjemi shqyrtimit të ligjshmërisë, që vie nga autoriteti mbikëqyrës.

Megjithatë, kërkesa është edhe në procesverbal dhe besoj që drejtori do të na përcjellë materialin.

Shqipe Kryeziu – Faleminderit kryesues! Përshëndetje nënkryetar, drejtorë dhe të gjithë. Nënkryetari dhe drejtori kanë qenë shumë të qartë në deklaratimet e tyre. Është mirë dhe propozoj që ky material të përgatitet për mbledhjen e ardhshme, që i bie pas një muaji.

Burim Krasniqi – Shqipe, askush nuk tha që patjetër të jetë për këtë seancë! Kryesore është që ta kemi informatën.

Afrim Limani – Përshëndetje kryesues! Përshëndetje anëtarë të KPF-së dhe gjithë të pranishmit. Rreth kërkesës së Burimit: Shpresoj ta kem mirëkuptimin e juaj që brenda kësaj seancë nuk kam mundësi ta përgatis këtë raport, sepse në komunë janë auditorët, e dyta është që ka ardhë KAB-i komunal dhe si dokument me 6 qershor duhet ta dorëzoj. Mund ta provojmë duke e lënë opsionin e hapur, ta përgatis edhe këtë muaj, minimum 1 ose 2 ditë para seancës nëse është e mjaftueshme për ju.

Kryesuesi – Pasi që është dokument i rëndësishëm, në momentin që është gati e shqyrtojmë, nuk do të ishte problem se cilën seancë është, këtë që po vjen apo seancën e muajit të ardhshëm. Atëherë, po e vendosim në votim miratimin e rendit të ditës! Kush është “për”?... Me shumicë votash miratohet edhe rendi i ditës për sot.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi – A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së ndonjë gjë rreth procesverbalit? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës P- 71510069-01910-6, në zonën kadastrale – Retijë;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë, të nderuar anëtarë të KPF-së. Para jush keni propozimin e kryetarit të komunës për marrjen e vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim personave fizikë dhe juridikë për 15 vjet. Bëhet fjalë për parcelën me numër 01910-6, në zonën kadastrale – Retijë. Kërkojmë të marrim vendim për 3 ha, me qëllim të destinimit bujqësor.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së diçka për të thënë rreth kësaj pike? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim! Kush është “për”?... Me shumicë votash a provohet edhe pika e dytë e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P- 71510069-01910-6, në zonën kadastrale – Retijë;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues! Sipas ligjit kërkohet që të formohet një komision për zhvillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të parcelës së njëjtë me nr. **01910-6**. Komisioni si zakonisht përbëhet prej pesë anëtarëve, dy nga ekzekutivi, dy nga kuvendi dhe një nga sektori joqeveritar.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së diçka për të thënë rreth kësaj pike?

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues! Është mirë që në mbledhjen e kuvendit t’i emrat e anëtarëve të ekzekutivit për këtë komision.

Kryesuesi – Faleminderit Burim! Nëse edhe dikush nuk ka ndonë gjë për të thënë! Po e vendosim në votim! Kush është “për”?... Me shumicë votash aprovet pika e tretë.

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës P- 71510002-01002-0, në zonën kadastrale – Bellacërkë;

Afrim Oruqi – Bëhet fjalë për zonën kadastrale në Ballacërk, për dhënien në shfrytëzim 15 vjet me nr të parcelës **01002-0** dhe me sipërfaqe të përgjithshme prej 3858m². Qëllimi ka të bëjë me rritjen e vlerës dhe kultivimin e bujqësisë dhe blektorisë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së diçka për të thënë rreth kësaj pike? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë unanime miratohet edhe pika e katërt.]

5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P- 71510002-01002-0, në zonën kadastrale – Bellacërkë;

Afrim Oruqi – Për të njëjtën parcelë me nr. **01002-0**, sipas ligjit duhet të formohet një komision për vlerësimin e ofertave dhe vazhdimin e procedurave tjera tutje. Komisioni si zakonisht përbëhet prej pesë anëtarëve, dy nga ekzekutivi, dy nga kuvendi dhe një nga sektori joqeveritar.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së diçka për të thënë rreth kësaj pike? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë unanime miratohet edhe pika e pestë.

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-7151057-02240-1, në zonën kadastrale – Rahovec;

Afrim Oruqi – Bëhet fjalë për zonën kadastrale në Rahovec në sipërfaqe prej 10.000m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7577401 m katror. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik është këmbimi i pronës komunale me pronën e institucionit qendror.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së diçka për të thënë rreth kësaj pike? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë unanime miratohet edhe pika e gjashtë.

7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për shpronësimin e pronës së paluajtshme P- 71510052-00363-0, Zona Kadastrale Mrasor;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues! Propozohet të jepet pëlqimi për të iniciuar procedurën për shpronësim të pronës së paluajtshme private për interes të përgjithshëm publik për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e shtëpisë – shtapit të UÇK-së në zonën e Mrasorit. Çertifikata e pronësisë është në emër të Sokol (Rexhë) Rexhepi me sipërfaqe prej 240m², kjo sipërfaqe në total është 10.610 m².

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së diçka për të thënë rreth kësaj pike? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë unanime miratohet edhe pika e shtatë.

8. Informatë mbi qarkoren e parë buxhetore 2024/01;


Afrim Limani – Faleminderit kryesues! Ministri për Financa, Punë dhe Transfere është i autorizuar që në përputhje me nenin 20 të Ligjit Nr.03/-048 për Menaxhimin e Financave publike dhe Përgjegjësitë, të nxjerrë qarkoren buxhetore për cilëndo organizatë buxhetore me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e buxhetit të Kosovës. Qarkorja buxhetore përmban parashikimet për implementimin e buxhetit 2023, kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit 2024-2026, programin për investime publike (PIP) dhe sa i përket komunave kemi burimet e financimit komunal për 2024-2026 (granti i përgjithshëm), ku përcaktohen grantet qeveritare për financimin e komunave për 2024 dhe orinetimet për 2025-2026.

9. Të ndryshme;

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! Atëherë, jemi te pika e fundit e mbledhjes, nëse dikush ka diçka për të thënë?... Nëse jo, atëherë po e përmbyllim mbledhjen e pestë të KPF-së për 2023, mirëmbetshi!

Mbledhja përfundoi në ora 10:40

Procesmbajtësi;


Albion Krasniqi


KRYESUESI

Afrim Kallmeti

